



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.510/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, duke vendosur në procedurën konetstimore sipas padisë së paditëses R. T., nga Gjilani, Rr."Muharrem Ibrahim", nr.III/78,të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Bardhosh Dalipi, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Burim Maliqi nga Gjilani, për kompenzimin e pagave jubilar dhe percjellëse në pension, pas mbajtjes së seancës gjyqësore dhe publike me datën17.01.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses R. T. nga Gjilani.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Arsimit, që paditëses t’ia paguaj tri paga për percjellje në pension në shumë prej **1,438.39 €**, dhe për shpërblim jubilar shumë prej **631.50 €**, në shumë të përgjithshme prej **2,069.89 €**, me kamatë ligjore prej 8 % , nga data 17.01.2019, si datë e dhënies së këtij aktgjykimit e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit 7 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses e kërkuar në emër të percjelljes në pension, në lartësi prej 33.32 €, ma shumë se shuma e gjykuar refuzohet si e pabazuar me ligj.

III. Detyrohet e paditura që t’ia kompensoj paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 269.20 €, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja R. T., nga Gjilani, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, në këtë gjykatë, me datën 28.05.2018, ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria e Arsimit, për kompenzimin e pagave për shpërblim jubilar në vlerë prej 731.53 euro, dhe tri (3) paga mujore për percjellje në pension me rastin e pensionimit në vlerë prej 1,463.07 euro, në vlerë të përgjithshme prej 2,194.60 euro, me kamat ligjore prej 8%, në vit nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, si dhe e paditura ti kompensoj shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e paditsit, njëkohësisht duke e paralajmëruar të paditurën, që nëse brenda afatit të paraparë ligjor nuk përgjigjet, gjykata do të merr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë-mosbindjes, nëse plotësohen kushtet ligjore, çka e paditura në përgjigjen në padi të dates 17.08.2018, ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke e arsyetuar se Kontrata Kolektive nuk prodhon efekt juridik dhe nuk

krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit dhe se ajo kontratë konsiderojnë se nuk është në fuqi.

Përfaqësuesi i palës paditëse av.Bardhosh Dalipi, në shqyrtimin gjyqësor të datës 17.01.2019, ka bërë precizimin e padisë sa i përket shumës së kërkuar me kërkesëpadi dhe ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë në emër shpërblimit jubilar për më tepër se 40 vite përvojë të punës vlerën prej 631.50 euro ($421 \times 150\% = 631.50$) dhe tri paga përcjellëse në pension shumë prej 1,471.71 €, në shumë të përgjithshme prej 2,103.21 euro, me kamat vjetore prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë, deri ne pagesën definitive të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, ndërsa pjesa tjetër e padisë ka mbetur e pa ndryshuar, si dhe I ka kërkuar shpenzimet e procedurës për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, për një seancë shumë prej 135.20 euro, për taksën gjyqësore për padi shumë prej 30 euro të gjitha këto në shumë prej 269.20 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës Burim Maliqi, në shqyrtimin gjyqësor dhe fjalën përfundimtare¹ e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si dhe i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë sit ë pabazuar po ashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga gjykata që konform nenit 68 lidhur me nenin 67 të Ligjit për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë (Ligji NR/03/L-221) ta pezullojë rastin në afat prej 180 ditësh si dhe ta njoftojë Ministrinë e Drejtësisë, mbi rastin dhe të njejtës ti sigurojë një kopje të plotë të lëndës, dhe pas zbatimit të këtyre dispozitave të vazhdohet me shqyrtimin e lëndës.

Gjykata edhe përkundër propozimit të paditurës për pezullimin e procedurës conform nenit 68 lidhur me nenin 67 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit, nr.03L/048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë, pasi që konstaton se një pezullim i tillë për rastet e paraqitura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk është i detyrueshëm, por detyrimi i tillë rrjedhë vetëm për rastet e pazgjidhura para hyrjes ne fuqi të këtij ligji.

Po ashtu kjo dispozitë ligjore sipas gjykatës është në kundërshtim me nenin 3 të Dispozitave Themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 24- pjesa lidhur me Liritë dhe të Drejtat e Qytetarit –ku citohet se të „*gjithë janë të barabartë para ligjit*”, e që në nenin 22 te Kushtetutës së Kosovës „*të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare garantohen me këtë Kushtetutë, e të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike*”, e që Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në nenin 6 të saj citon „*çdo person ka të drejt për në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, që nënkupton edhe të drejtën në një gjykim të shpejtë e që në rastin konkret kur kemi të bëjmë me të drejta të perealizuara nga mardhënia e punës, ku sipas nenit 475 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, procedura nga mardhënia e punës është urgjente.*

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për t'i vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe për ta vërtetuar drejt gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale:Kontratën e Punës me numër 124, e datës 01.09.2015; Vendimin mbi përvojën e punës dhe të drejtën në pension e datës 12.03.2018, e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Përgjigja në kërkesë me numër 26496, e datës 21.03.2018; Libreza e Punës më numër 48077, në emër të paditëses; Vërtetimi mbi përvojën e punës më numër 13/2019; Lista e pagave për muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2017 dhe muajin janar të vitit 2018.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve te palëve ndërgjyqëse dhe provave te nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është **pjesërisht e bazuar**.

¹ Përfaqësuesi i të paditurës Burim Maliqi, fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në formë të shkruar.

-Nga Kontrata e Punës në Kohë të Pacaktuar me numër të protokollit 124 e datës 01.09.2015, gjykata vërtetoi faktin se paditësja nga muaji nëntor i vitit 2015 ka punuar në SHFMU “Selami Hallaçi”, si mësimdhënëse e ciklit klasor me orar të plotë dhe për shkak të fuqisë së ligjit-moshës së pensionimit prej 65 vjeç, i’u është ndërprerë marrëdhënia e punës, me datën 16.02.2018.

-Sipas përmbajtjes së Vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “Selami Hallaçi”, në Gjilan, me numër 13/2019, i datës 16.01.2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka punuar në këtë shkollë si mësimdhënëse e rregullt në ciklin klasor nga data 16.10.1979 e deri më 16.02.2018 dhe ka gjithësej përvojë të punës në këtë shkollë ka **37 vite e 4 muaj**.

-Nga Libreza e punës me numër 21065/74, në emër të paditëses, gjykata vërtetoi se e njëjta që nga data 03.04.1974 e deri më datën 31.08.1976, ka qenë në marrëdhënie të punës në Shkollën Filllore “19 Nëntori” në fshatin Hade, nga data 01.09.1976 e deri më datë 31.08.1978, ka qenë në marrëdhënie të punës në Gjimnazin “Zenel Hajdini”, në Gjilan, nga data 01.09.1978 e deri më datë 31.12.1978 ka qenë në marrëdhënie të punës në “Sonobor”, ndërsa në SHFMU “Selami Hallaçi”, në Gjilan, nga data 16.10.1979 e deri në përfundim të marrëdhënies së punës sipas fuqisë së ligjit-pensionimit me datën 16.02.2018 dhe ka gjithësej përvojë të punës **42 vjet e 27 ditë**.

-Ndërsa nga Përgjigja në Kërkesë e Drejtorisë së Arsimit në Gjilan me numër 26496, e datës 21.03.2018, gjykata vërtetoi faktin se e paditura ka theksuar se ekzekutimin e pagave e bënë Ministria e Financave, gjegjësisht divizioni i pagave në kuadër të kësaj ministrie dhe se për shkak se ende nuk është duke u zbatuar Kontrata Kolektive për sa i përket këtyre pagesave, ministria nuk po i ekzekuton asnjë pagesë e në rastin konkret pagesat pas pensionimit.

-Nga leximi i listës së pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës në emër të paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka realizuar të ardhura personale neto për muajin nëntor-473.91€, dhjetor-473.91€ dhe janar të vitit 2018 pagën prej 490.57€, kurse paga bazë e paditëses është 421 €, në muaj.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lartë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar pjesërisht, pasi që nga provat e administruara u vërtetua se paditësja ka të drejtën e kompenzimit të tri pagave për përcjellje në pension si dhe për 40 vite përvojë pune në vlerë prej 150 %, të një page bazë, për shpërblim jubilar duke u mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përkatësisht në nenin 35 paragrafi 8, pika 8.4 dhe 9, si dhe nenin 48 po të njëjtes kontratë, e që paditësja me datën 16.02.2018, i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit (pensionimit) .

Poashtu sipas dispozitës së lartëcekur gjykata ka vërtetuar se paditësja i takojnë tri paga për përcjellje në pension në shumë prej 1,438.39 €, dhe në lartësin e një page bazë për shpërblimin jubilar në vlerë të 150 % ,në shumë prej 631.50, e në shumë të përgjithshme prej 2,069.89 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses në lartësi prej 33.32 €, e kërkuar ma shumë se shuma e gjuetar të kërkuar në emër të tre pagave të fundit mesatare, nga fakti se në nenin 35 pika 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar se **“punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”**, ashtu që konform listës së pagave, pasqyrat bankare paga bazë e paditësit në tre muajtë e fundit ka qenë(për muajin nëntor 473.91 €, për muajin dhjetor 473.91 €, ndërsa për muajin janar ka qenë 490.57€), e në rastin konkret gjykata ka vepruar duke i mbledhur tri shumatat dhe duke i pjestuar me tre, e mesatarja për tre muajt e fundit është 479.46 €,(479.46 € x 3=1,438.39 €), ndërsa paditësja në kërkesën e saj ka kërkuar kompensimin sipas pagës së fundit, e që sipas dispozitës së lartëcekur punëtori duhet të paguhet me tri paga të fundit mesatare, që gjykata me këtë nënkupton pagën

neto të paditësit, çka gjykata pjesën tjetër me shumë se shuma e gjykuar ka vendosur si në pikën II të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës për bazën ligjore të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, ku kjo gjykatë erdhi në përfundim se Kontrata Kolektive e cila ka hyrë në fuqi më datë 18.04.2017, paraqet bazë ligjore për themelësinë e kërkesëpadisë së paditëses, pasi që Marrëveshja Kolektive e Arsimit në Kosovë, rregullon të drejtën në pension bazë dhe që Ligji i Punës i Kosovës, shprehimisht nuk parasheh me ndonjë dispozitë ligjore kompensimin e pagave dhe shpërblimin jubilar çka edhe rrjedhë përfundimi se kërkesëpadia e paditësit ka mbështetje ligjore dhe si e tillë është aprovuar si e bazuar në ligj (Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës e dt.18.04.2017), e që në nenin 48 të kësaj kontrate shprehimisht thuhet se *“Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate shfuqizohet Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar në mes të MASHT-it dhe SBASHK-ut, nr.01B-2200, datë 11.04.2014”*, çka e njëjta paraqet bazë ligjore për realizimin e të ardhurave personale pas pensionimit.

Gjykata vendosi që konform nenit 452.1 të LPK-ës, ta detyroj palën e paditur që t’ia kompensoj paditëses shpenzimet e procedurës kontestimore edhe ate për përpilimin e padisë shumë prej 104 €, për një seancë të mbajtur shumë prej 135.50 € si dhe për taksën gjyqësore për padi shumë prej 30 euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 269.20 €, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga të lartcekurat më lartë, e konform nenit 35 paragrafi 8 pika 8.4, dhe paragrafit 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, si dhe nenit 143 të LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr. 510/18, më datë: 17.01.2019

Gjyqtarja
Florije Qerimi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën së Apelit në Prishtinë, ndërsa ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.